



## PROCESVERBAL

### Nga mbledhja e X-të (IX-të për v. 2010) e Kuvendit Komunal në Vushtrri, mbajtur më 28.10. 2010

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë.

**Ferit Idrizi-** propozoi që të futet në rend dite propozimvendimi për nderimin e familjes së Komandantit legjendar Adem Jashari, me çmimin “Hasan Prishtina”. Poashtu propozoi që pikat 3,4 dhe 5 të rendit të ditës të diskutohen në pjesën e dytë të seancës, pasi që drejtori i arsimit është i zënë me pritjen e përfaqësuesve të gjimnazit të Durrësit.

**Besim Jashari-** paraqiti shqetësimin lidhur me çështjen e vërshimeve, dhe kërkoi që të diskutohet edhe për çështjen në fjalë. Pastaj tha se shtrati i lumit “Tërstena” (pjesa e mesit) është mbushur me mbeturina, me barishta, pra është ngritur niveli edhe pa ujë. Poashtu probleme të ngjashme ka edhe te mburojat e lumit “Sitnica”, dhe në vende tjera.

**Bajram Mulaku-** tha se qeveria komunale merret në vazhdimësi me çështjen e parandalimit të vërshimeve. Mandej duke iu referuar shtratit të lumit “Tërstena”, garantoj se nuk do të ketë kurrë më vërshime në qytetin e Vushtrrisë për shkak të shtratit të lumit “Tërstena”. Pastaj tha se Drejtoria e Shërbimeve Publike është përkujdesur edhe në rastet tjera të evitimi mundësinë e vërshimeve, dhe si shembull përmendi rastin mes Vushtrrisë dhe Nedakocit, ku është një kanal pothuajse i mbyllur prej disa qytetarëve me disa nënkalime, disa gypa me kapacitet jo të mjaftueshëm, prandaj Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Inspektionit kanë intervenuar dhe këto janë sanuar. Sa i përket dëmtimeve, apo mos ndërtimit të

bankinës me kohë, siç është rasti në Pestovë, tha se nuk është detyrë e qeverisë, por është brengë e qeverisë, prandaj njoftoi se kanë ndarë edhe një shumë të mjeteve për vitin e ardhshëm që të sanohen ato dëmtime dhe punët eventualisht të pambaruara. Në fund tha se disa punë jo të mira janë trashëguar nga e kaluara, sidomos kanalizimet e ujërave atmosferike, duke shtuar se janë bërë kanalizime të ujërave atmosferike me gypa F100 (Fi 100), dhe kërkoi që të gjendet mënyrë që të hiqen ata gypa me fyt të ngushtë dhe të zëvendësohen me gypa me fyt të gjerë.

**Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi në mënyrë unanime aprovoi këtë:**

***Përveç ftesës së rendit të ditës, u vendos që të përfshihen në rend dite edhe propozimet e paraqitura nga Ferit Idrizi.***

## **R E N D I T E**

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e KK-së mbajtur më 30.09.2010.**
- 2. Shqyrtimi i informatës lidhur me realizimin e të hyrave vetanake buxhetore për muajin Korrik - Shtator 2010.**
- 3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për dhënien e lejes së punës të Organizatave të biznesit në territorin e Komunës së Vushtrrisë. (shqyrtimi i parë).**
- 4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për fillimin dhe mbarimit të orarit të punës të bizneseve në lëmin e tregtisë,hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimeve tjera në territorin e Komunës së Vushtrrisë.(shqyrtimi i parë).**
- 5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndërrimin e pronave të paluajtshme në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Rexhep Haxhaj nga Stanovci i Epërm.**
- 6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndërrimin e pronave të paluajtshme në mes Komunës së Vushtrrisë dhe Imer Lutollit nga Vushtrria.**
- 7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim të tokës në pronësi të Komunës.**
- 8. Shqyrtimi i Informatës për fillimin e vitit të ri shkollor 2010/2011.**
- 9. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për organizimin e punës dhe të mësimit në shkollat fillore të Komunës së Vushtrrisë. (shqyrtim i dytë).**
- 10. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për organizimin e punës dhe të mësimit në shkollat e mesme të ulëta të Komunës së Vushtrrisë. (shqyrtimi i dytë).**
- 11. Shqyrtimi i propozimvendimit për ndarjen e çmimit “Hasan Prishtina” për familjen e Komandantit legjendar Adem Jashari.**
- 12. Eventuale.**

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e KK-së mbajtur më 30.09.2010.**

**Muharrem Shabani-** tha se procesverbali nuk përmban aspak gjendjen reale çfare ka qenë në seancën e kaluar. Pastaj tha se kur një grup parlamentar është kundër, të shënohet taksativisht se grupi parlamentar i një partie është kundër. Mandej lidhur me pikën nr. 12 të rendit të ditës, tha se kanë kërkuar edhe heqjen e kësaj pike nga rendi i ditës dhe zbatimin e procedurave ligjore, por ajo kërkesë e grupit parlamentar të AAK-së është mbivotuar, prandaj nuk është shënuar në procesverbal

se grupi parlamentar i AAK-së gjatë shqyrtimit dhe votimit e ka lëshuar sallën ku mbahej seanca e Kuvendit. Në vazhdim tha se në vend të 2 hektarëve që kanë qenë të propozuar, tash iu ka shtuar edhe sipërfaqja prej 1 hektari të dhënies së pronës, dhe ka qenë një qëndrim paraprak që të jenë kryesisht prodhuese, por janë dhënë edhe për lëmi tregtare. Në fund tha se si grup parlamentar i AAK-së janë kundër këtij procesverbal, deri sa të përmirësohet.

**Refik Ramaj**- lidhur me pikën 2 të rendit të ditës, gjatë diskutimit të tij kërkoi që pjesa e fjalisë “participimi nga bujqësia nuk është i kënaqshëm”, të korrigjohet dhe të thuhet: “participimi i planifikimit të buxhetit për shpenzimet në subvencionimin e bujqësisë”.

**Veli Karaça**- paraqiti vërejtje lidhur me pikën 7 të rendit të ditës, duke thënë se mungon diskutimi i tij për pikën në fjalë.

**Pajazit Pllana**- gjatë diskutimit të tij në pikën 2 të rendit të ditës, kërkoi që të precizohet se “fshati Shtitaricë nuk ka dalje në asfalt”, pastaj kërkoi që në vazhdim të fjalisë të fshihet pjesa e fjalisë “për arsye”. Gjithashtu tha se ky projekt realizohet në rrugën e vjetër që lidhet prej varrezave, e deri në vendin e quajtur “bregu i dredhëzave”.

**Sabit Kadriu**- tha se kësaj here ka mangësi në procesverbal. Pastaj tha se nuk janë përfshirë edhe disa vendimmarrje, duke kërkuar në vendimmarrja do të duhej të përfshihej në procesverbal. Në fund kërkoi që procesverbalin në fjalë të korrigjohet edhe një herë.

**Besim Jashari**- pasi që u pajtua me vërejtjet e parafolësve, tha se në punimet e Kuvendit marrin pjesë 3-4 zyrtarë nga Sekretaria e Kuvendit, prandaj nuk është serioze të ndodhin këto lëshime. Pastaj paraqiti vërejtje pasi që ka marrë përgjigje për pyetjet e parashtruara në seancën e fundit, duke shtuar se nuk është në rregull që t’ia dorëzojnë përgjigjet e pyetjeve nga seanca e kaluar, në ditën e seancës së radhës. Në vazhdim ai tha ndër çështjet që ka shtruar, ka qenë problemi i zënies së tokës bujqësore, dhe fatkeqësisht asaj që është nën sistemin e ujitjes, dhe ka kërkuar që dihet se a ka masa që këto trende jashtëzakonisht negative të stopohen, por bëri të ditur se nuk e ka marrë këtë përgjigje. Mandej tha se ka kërkuar përgjigje nga Drejtoria e Arsimit pse neve publikisht na është thënë se asnjë shkollë në Komunën e Vushtrrisë nuk do të filloj me 1 shtator pa emër, dhe përsëri në bazë të informatës së Drejtorisë së Arsimit figurojnë 6 shkolla që funksionojnë pa emër, dhe as për këtë pyetje nuk ka marrë përgjigje.

**Ferit Idrizi**- kërkoi që në procesverbal të mos jenë komplet diskutimet, por të përfshihet vetëm esenca e asaj që delegati e thotë.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 28 vota “për”, 6 “kundër”, të tjerët “abstenim”, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**  
*Aprovohet procesverbalin i mbledhjes së fundit të Kuvendit të Komunës, me vërejtjet e paraqitura nga: M.Shabani, R.Ramaj, V.Karaça, P.Pllana, S.Kadriu, B.Jashari.*

**2. Shqyrtimi i informatës lidhur me realizimin e të hyrave vetanake buxhetore për muajin Korrik - Shtator 2010.**

**3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për dhënien e lejes së punës të Organizatave të biznesit në territorin e Komunës së Vushtrrisë. (shqyrtimi i parë).**

**Nasuf Aliu**- paraqiti sqarimet hyrëse.

**Ismet Gashi**- në emër të grupit asambleistë të LDK-së paraqiti këto vërejtje: te neni 3 numërohen disa kushte, dhe te neni 7 përsëri numërohen disa kushte të veçanta, prandaj kërkoi që të harmonizohet neni 3 me nenin 7. Te neni 9, tha se nuk është

mirë të stimulohet veprimtaria ilegale e ndërtimeve, që t'iu epet shndërrimi i lokalit banesor në lokal afarist, pra pa e bërë shndërrimin, t'i epet leja e punës, pa i kryer obligimet ndaj Komunës, dhe kërkoi që neni 9 të hiqet. Pastaj te neni 12.4 , tha se është i tepërt, pasi që kjo është çështje e organit të shkallës së dytë, i cili e njofton palën për të drejtën për ankesë për të bërë padi në Gjykatën Supreme.

**Nystret Gërxhaliu-** pasi që e vlerësoi pozitivisht Draftregulloren në fjalë, propozoi që në nenin 9 të futet pika “e” e nenit 7-të, pasi që ka biznese që funksionojnë më herët, por nuk i kanë kryer obligimet, kurse tani e kanë radhën që kur të legalizojnë veprimtarinë e vet, t'iu kërkohet kryerja e obligimeve ndaj Komunës.

**Refik Ramaj-** paraqiti dy pyetje: e para, lidhur me emërtimin e kësaj Draftregulloreje, duke pyetur pse është përdorur “Organizatave të biznesit”, duke shtuar se ka mundur të gjendet një term më i përshtatshëm. Pastaj tha se po iu epet leja e punës, pa marrë një vërtetim që i ka kryer biznesi obligimet ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, por edhe ndaj qeverisë komunale.

**Habibe Gërxhaliu-** lidhur me tatimet komunale për bizneset, propozoi që gratë të cilat janë kryefamiljare të lirohen së paku një vit nga tatimet komunale.

**Nasuf Aliu-** lidhur me nenin 9.1 nën “b”, tha se arsyet kanë qenë të bazuara në disa raste ku pronarët e objekteve kanë qëlluar borxhlinjë, kurse shfrytëzuesit e lokaleve janë të rregullt në kryerjen e obligimeve. Pastaj vazhdoi duke iu përgjigjur vërejtjeve të anëtarëve të Kuvendit.

**Qazim Azemi-** në emër të grupit asambleistë të AAK-së propozoi që të hiqet neni 9-të. Pastaj lidhur me nenin 13, propozoi që organizuesit biznesor gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre, nuk posedojnë leje pune, t'iu ndërprehet puna.

**Ferit Idrizi-** propozoi që draftregullorja të procedohet për diskutim publik.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

***Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për dhënien e lejes së punës së organizatave të biznesit në territorin e Komunës së Vushtrrisë.***

***Diskutimi publik zgjatë nga data 29.10.2010 deri 19.11.2010.***

**4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për fillimin dhe mbarimit të orarit të punës të bizneseve në lëmin e tregtisë,hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimeve tjera në territorin e Komunës së Vushtrrisë.(shqyrtimi i parë).**

**Nasuf Aliu-** paraqiti sqarimet hyrëse.

**Refik Ramaj-** propozoi që Draftregullorja të ketë një emërtim tjetër, duke propozuar këtë emërtim: “Rregullore për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve që operojnë në Komunën e Vushtrrisë”.

**Esat Beka-** kërkoi që neni 15.3 të përmirësohet dhe të thuhet “barnatoret në të gjithë qytetin”. Gjithashtu propozoi që një barnatore të jetë e hapur 24 orë në mënyrë rutinore në qytetin e Vushtrrisë.

**Veli Karaça-** paraqiti vërejtje që asnjë ndryshim që propozohet dhe votohet në Kuvend nuk përfshihet në ndryshimin e vendimeve, rregulloreve dhe akteve tjera. Poashtu tha se edhe materialet që përgatiten, nuk merren sugjerimet e KPF-së. Mandej tha se asnjë anëtarë i Kuvendit nuk e ka buxhetin që është miratuar, pra nuk e kanë një pasqyrë as të buxhetit dhe as të projekteve. Në fund tha se kanë kërkuar edhe një listë të vendimeve që janë marrë në Kuvend, për ta kuptuar se a janë duke u zbatuar.

**Bahrije Pllana-** paraqiti vërejtje për mungesën e Kryetarit të Komunës në mbledhjet e KPF-së.

**Bajram Mulaku-** u përgjigj se as në seancat e Kuvendit nuk është i obliguar me marrë pjesë çdo herë, dhe duke iu referuar Ligjit për Vetëqeverisje Lokale tha se Kryesuesi i Kuvendit e ka për obligim për ta menaxhuar Kuvendin. Poashtu tha se

edhe në mbledhjet e KPF-së ka marrë pjesë, por nuk ka mundur të merr pjesë në mënyrë të rregullt pasi që ka angazhime të shumta.

**Pajazit Pllana-** tha se në nenin 15 mungojnë: diagnostika, laboratorët, rëntgenet dhe shërbimet e ultrazërit, duke kërkuar që të futen si pjesë e asaj që të respektohet orari i punës. Pastaj tha se nuk thuhet “në raste urgjente”, por thuhet “në raste emergjente”. Pastaj lidhur me nenin 15.2, tha se duhet të specifikohet se kush mund të punon, e kush nuk mund të punon. Mandej lidhur me nenin 15.3, propozoi që në bisedë me të gjithë pronarët e barnatoreve të krijohet një orar dhe rend, në mënyrë që qytetarët të furnizohen me barëra dhe terapi të nevojshme sipas kërkesës që mjeku i udhëzon, pasi që ka mungesë të madhe të barërave, edhe në nivelin primar edhe në atë sekondar, furnizimi është i dobët, dhe pacienti që vjen në orët e vona të natës nuk ka si të trajtohet.

**Në vazhdim Kuvendi për disa minuta i ndërpreu punimet e rregullta, për t'i pritur dhe shprehur falënderimet delegacionit që përfaqësonte gjimnazin e Durrësit.**

**Pastaj vazhduan punimet e Kuvendit, sipas kësaj radhitje të diskutuesve:**

**Muharrem Shabani-** tha se qëllimi i një rregulloreje është zbatimi i një rregullative juridike dhe vënia e një rendi dhe disipline në këto shërbime, në lëmi të caktuara, por është edhe lehtësimi i jetës së qytetarëve dhe të bizneseve. Pastaj lidhur me nenin 5, propozoi që të shënohet vetëm njëri orar për të dy periudhat, pasi që janë paraqitur dy ndarje stinore, kurse orari është i njëjtë. Pastaj, tek çështja e tregut të gjelbër, tha se duhet të hulumtohet a është drejt apo nuk është drejt, pasi që qytetarët që janë në marrëdhënie pune kanë kohë të lirë të shtunave dhe të dielave për blerje të zarzavateve dhe të ushqimeve të freskëta, prandaj pyeti pse të mbyllet ajo? Në vazhdim u pajtua me propozimet e Pajazit Pllanës. Në fund tha se shqetësuese është çështja e ndotjes akustike të qytetit, sidomos në kohën e verës, prandaj kërkoi rregullimin e çështjes në fjalë.

**Habib Mustafa-** duke iu referuar nenit 15.1, propozoi që orari i punës të mbaron në ora 24, kurse kujdestaria të fillon prej orës 24:00.

**Nasuf Aliu-** lidhur me nenin 15.3, sqaroi se nuk e kanë caktuar që vetëm një barnatore të ketë kujdestari 24 orë, por ka menduar që Drejtoria për Shëndetësi ta mban këtë përgjegjësi duke e hartuar planin në koordinim me barnatoret dhe me sektorët tjerë në lëmin e mjekësisë.

**Muharrem Shabani-** duke iu referuar nenit 15.3, kërkoi që të mos bëhet diskriminim ndaj barnatoreve tjera, të cilat nuk janë në afërsi të shërbimeve mjekësore.

**Bajram Mulaku-** kërkoi që neni 15.2 të definohet saktë.

**Veli Karaça-** tha se të gjitha vërejtjet e paraqitura për Draftregulloren në fjalë duhet të aprovohen, dhe teksti i ndryshuar të shkon në diskutim publik, kurse vërejtjet nga diskutimi publik t'iu vijnë anëtarëve të Kuvendit me material shtesë.

**Sabit Kadriu-** tha se Komuna duhet t'ua caktojë një orar të kujdestarisë me radhë të gjitha barnatoreve, pasi që sëmundjet shfaqen edhe gjatë orëve të vona të natës.

**Ismet Gashi-** duke iu referuar nenit 14, dhe nenit 15.2, tha se nëse mund të punohet 24 orë, jashtë këtij orari nuk ka ku të punon, prandaj propozoi që kjo pikë të jetë kështu: “në raste urgjente mund të kufizohet orari i punës”, pasi që në nenin 14 është 24 orë.

**Ferit Idrizi-** propozoi që në bashkëpunim me barnatoret të koordinohet orari i kujdestarisë, dhe ai orar të vendoset në tabelën e shpalljeve në QKMF, dhe të paraqiten detajet për secilën barnatore që e ka radhën për të kujdestaruar.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

***Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në lëmin e tregtisë, hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimeve tjera në territorin e Komunës së Vushtrrisë.***

***Diskutimi publik zgjatë nga data 29.10.2010 deri 19.11.2010.***

**Në vazhdim u diskutuan bashkarisht këto pika të rendit të ditës:**

**5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndërrimin e pronave të paluajtshme në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Rexhep Haxhaj nga Stanovci i Epërm.**

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

***Lejohet ndërrimi i patundshmërive në mes të Komunës së Vushtrrisë në njërën anë, dhe Rexhep Haxhaj nga fshati Stanoc i Epërm në anën tjetër.***

***Komuna e Vushtrrisë si pronare e ngastrës kadastrave P-70202021-01329-1, Certifikata e pronësisë UL-70202021-00144, ZK Pronaj, bën ndërrimin e një pjese të kësaj ngastre kadastrave në sipërfaqe prej 591 m<sup>2</sup> (e cila sipërfaqe do t'i bashkohet parcelës P-70202021-00986-0), me pjesë të ngastrës kadastrale P-70202021-00947-0 me sipërfaqe prej 4.82 m<sup>2</sup> dhe pjesë e parcelës P-70202021-00948-0 me sipërfaqe prej 109 m<sup>2</sup>, sipërfaqja e përgjithshme prej 591 m<sup>2</sup>, ZK Pronaj, pronë e Rexhep Haxhaj nga fshati Stanoc i Epërm.***

**6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndërrimin e pronave të paluajtshme në mes Komunës së Vushtrrisë dhe Imer Lutollit nga Vushtrria.**

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

***Lejohet ndërrimi i patundshmërive në mes të Komunës së Vushtrrisë në njërën anë, dhe Imer Lutollit nga Vushtrria në anën tjetër.***

***Komuna e Vushtrrisë si pronare e ngastrës kadastrale P-70202016-03556-0, Certifikata e pronësisë UL-70202016-01534, ZK Vushtrri, bën ndërrimin e një pjese të kësaj ngastre kadastrale në sipërfaqe prej 120 m<sup>2</sup> me pjesë të ngastrës kadastrale P-70202016-02974-28, Certifikata e pronësisë UL-70202016 në sipërfaqe prej 120 m<sup>2</sup>, ZK Vushtrri, pronë e Imer Lutollit nga Vushtrria.***

**7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim të tokës në pronësi të Komunës.**

**Nezir Klinaku-** paraqiti sqarimet hyrëse për tri pikat e rendit të ditës.

**Muharrem Shabani-** lidhur me dy vendimet e para, tha se është mirë që të shënohet qëllimi i ndërrimit, pasi që nuk është shënuar fare në dispozitivin e vendimit.

**Ismet Gashi-** tha se nëse aprovohet ky vendim, drejtorja gjegjëse nuk ka mundësi të regjistrohet në librat kadastral në këtë formë qysh është vendimi, pasi që nuk është cekur në asnjë nen që ndërrohet edhe destinimi, prandaj duhet të ceket kultura, pasi që e njëjës është arë, kurse tjetra në fletë poseduese figuron rrugë, prandaj duhet të ceket se me këtë vendim i ndërrohet edhe destinimi. Kurse tek rasti i I. Lutollit, tha se në dispozitiv të vendimit nuk janë dy parcelat që bëhet ndërrimi, kurse komisioni i ka dhënë vlerësimet për dy parcelat, pronë e Komunës, që bëhet ndërrimi.

**Ferit Idrizi-** i mbështeti propozimet që me një nen të shtohet qëllimi, kurse me nenin tjetër ndërrimi i destinimit të kulturës.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me 31 vota “për”, 3 “kundër”, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

***Me këtë vendim ipet në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim, në afat prej 10 (dhjetë) vjetësh me mundësi vazhdimi, toka në pronësi të Komunës, pjesë e parcelës kadastrale P-70202053-00573-1, Certifikata e pronësisë UL-70202053-00059, në sipërfaqe prej 100 m<sup>2</sup>, ZK Prelluzhë, për ndërtim të objektit të banimit për familjen e Xhemajl Hajrizit nga Prelluzha.***

## **8. Shqyrtimi i Informatës për fillimin e vitit të ri shkollor 2010/2011.**

**Qazim Azemi-** tha se Informata në fjalë është e vonuar dhe nuk është complete, kurse arsimit është prioritet vetëm me fjalë, prandaj po ka vonesa në renovime dhe në gjithçka tjetër që ka të bëjë me arsimin, gjithashtu premtimet nuk po mbahen, kur është fjala për prioritetet, duke përmendur premtimet e dhëna për ndërtimin e shkollës në Pestovë, Karaçë. Pastaj asnjë shkollë e qytetit nuk ka punuar në kushte normale, dhe renovimet e shkollave kanë filluar pas pushimit veror. Gjithashtu mbi dy javë kanë munguar në të gjitha shkollat ditaret dhe shkumësat. Kurse duke iu referuar çështjes së regjistrimit, tha se regjistrimi i nxënësve në klasën e X është bërë me kushte enorme për të dy shkollat e mesme, njëra teknike dhe tjetra profesionale. Në vazhdim tha se në gjimnaz ka shumë klasë, pra janë paraparë 14 klasa në gjimnaz, dhe kërkoi që t'i ipet prioritet shkollave teknike dhe profesionale. Gjithashtu tha se është qesharake që 5-6 shkolla akoma nuk kanë emra, dhe shtoi se ka edhe shkolla që janë emëruar, por nuk e kanë të vendosur emrin në shkollë. Poashtu ka shumë shkolla që kanë ushtrues detyre të drejtorit prej shumë vitesh, duke përmendur konkretisht shkollën fillore në Skromë dhe në Stroc. Në fund, duke iu referuar rubrikës së tretë të Informatës, tha se nuk dihet sa fatosa janë në total.

**Besim Jashari-** tha se gjendja në arsim nuk është e mirë. Poashtu mësimi nuk ka filluar në mënyrë të rregullt në gjimnaz dhe teknik, dhe se punët nuk po kryhen në kohën e caktuar. Pastaj mungon informata mbi gjendjen e kabinetëve, laboratorëve, sallave të sportit në shkolla të caktuara, çështja e mungesës së furnizimit me ujë për pastrim të duarve dhe për ujë të pijshëm nëpër shkolla, mbi gjendjen e higjienës dhe tualeteve. Lidhur me ushtruesit e detyrës së drejtorëve të shkollave, tha se kjo çështje është dashtë të kryhet para datës 1 shtator. Gjithashtu paraqiti shqetësimin që 6 shkolla vazhdojnë mësimin pa emra, duke kërkuar që sa më parë të emërohen shkollat me emra, duke propozuar disa prej këtyre emrave që t'iu vendosen shkollave: “Pavarësia”, “1 Shtatori”, “17 Qershori”.

**Esat Beka-** tha se gjatë kësaj qeverisje janë bërë investime të mëdha në arsim. Lidhur me Informatën në fjalë, tha se mungojnë informatat për gjendjen teknike të shkollave fillore. Pastaj pyeti lidhur me dy gjenerata të cilat janë në hoteleri turistike, dhe kanë përfunduar klasën e XII, mirëpo është mbyllur ky drejtim, çka mund të bëhet për ta, në mënyrë që t'iu mundësohet regjistrimi në nivele më të larta të arsimit?

**Sabit Kadriu-** tha se kjo Informata është dashtë të paraqitet në Kuvend në shtator, por përbrenda kësaj informate kanë mundur të jenë edhe disa elemente shtesë, të cilat do ta bënin më të plotësuar këtë informatë. Pastaj nuk është e vërtetë që ka filluar procesi mësimor më 1 shtator nëpër të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, pasi që është punuar në godina të shkollave fillore dhe me orar të shkurtuar. Mandej duke iu referuar listës së drejtorëve të shkollave, të paraqitur në Informata, tha se në Stroc mungon drejtori i shkollës, duke shtuar se është dashtë të shpallet konkursi dhe të plotësohen vendet vakante nëpër shkolla fillore. Pastaj paraqiti vërejtje duke thënë se dyert e Drejtorisë së Arsimit nuk po janë të hapura për mediat. Në vazhdim pyeti sa zbatohet ligjshmëria gjatë pranimit të kuadrit në procesin mësimor, sepse gjatë pranimit të kuadrit ka ankesa të mëdha nga qytetarët. Pastaj tha se ka raste që janë pranuar kuadro pa konkurs, dhe me këtë shkelet ligjshmëria, prandaj nuk

guxon të ndodh. Gjithashtu kërkoi që sa më shpejt të bëhet emërtimi i 6 shkollave. Mandej tha se tri shkolla fillore janë në të njëjtën listë të pagave, dhe ka raste kur edhe personit të vdekur i vjen paga në Komunë. Pastaj pyeti se si caktohet koeficienti për pagesa të kuadrove dhe të administratorëve nëpër shkolla, pasi që thuhet se koeficienti për paga caktohet në mënyrë paushalle. Gjithashtu pyeti sa janë të furnizuara bibliotekat dhe laboratorët me mjetet e konkretizimit? Cili është numri i saktë i punëtorëve teknikë të shkollave? Poashtu kërkoi numrin e saktë të nxënësve të të gjitha niveleve, por edhe numrin e tërësishëm të nxënësve dhe të arsimtarëve? Sa nxënës kanë mbetur pa u përfshirë në nivelin e shkollimit të mesëm të lartë? Në fund kërkoi që në panel të intervistimit të drejtorëve të shkollave të mos jenë vetëm zyrtarët e ekzekutivit, por të ketë edhe përfaqësues nga subjektet tjera politike.

**Qerim Selimi-** tha se pajtohet që në Informatë nuk janë të përfshira të gjitha çështjet, mirëpo kjo është një Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor, dhe Informata është e përqendruar në vështirësitë që e kanë përcjellur fillimin e vitit të ri shkollor. Pastaj tha se ka shkollat e qytetit kanë punuar me tri ndërrime, si rezultat e renovimeve dhe investimeve që janë bërë nëpër shkolla. Poashtu tha se është fakt që kanë munguar ditaret 14 ditë, por kjo është një procedurë e Drejtorisë së Prokurimit, mirëpo nuk është e vërtetë që kanë munguar shkumësat. Mandej tha se është e vërtetë që nxënësit në gjimnaz janë pranuar në bazë të kriterëve të Ministrisë së Arsimit, kurse në shkollat teknike janë hapur edhe dy paralele, me qëllim që të përfshihen nxënësit të cilët nuk e kanë arritur kriterin, ose ata që kanë sukses të shkëlqyeshëm, e që nuk janë pranuar në gjimnaz. Kurse lidhur me mungesën e karrigave, njoftoi se në gjimnaz kanë ardhur 500 karrige nga Ministria e Arsimit, kurse karrigat tjera janë bartur në shkollën teknike. Ndërsa lidhur me emërtimet e shkollave, tha se duhet bashkarisht me Kryetarin e Komunës të gjejmë emrat e qëndrueshëm dhe afatgjatë, dhe të mos jenë emra politik. Në vazhdim bëri të ditur se konkursi është i hapur për drejtorët e shkollave, dhe Udhëzimi Administrativ e përcakton se kush duhet të jetë anëtar i komisionit për pranimin e drejtorëve. Gjithashtu tha se gjendja e arsimit në shkollat fillore është e mirë. Ndërsa, kabinetet dhe laboratorët e shkollave nuk janë të furnizuar sa duhet me paisje të nevojshme, me përjashtim të shkollës “Bahri Haxha”, ku është një laborator shumë i furnizuar, e që është si rezultat i investimit të “Danidës”. Mandej tha asnjë shkollë nuk është e pafurnizuar me ujë, dhe shtoi se ngjyrosja dhe nyjet sanitare janë përmirësuar. Duke iu referuar pyetjes për klasët e XII-ta, të drejtimit të hotelarisë, tha se duhet të konsultohet me drejtorët e shkollave se si është e rregulluar kjo çështje me ligj. Gjithashtu tha se nuk është e vërtetë që dyert e Drejtorisë së Arsimit janë të mbyllura për mediat. Kurse lidhur me komisionet, tha se është çështje e ligjit, duke mos u pajtuar me atë që u tha se po pranohen kuadro profesional pa konkurs. Duke iu referuar ushtruesve të detyrës së drejtorëve të shkollave, tha se shkolla e Skromës nuk mund të jetë e pavarur, prandaj duhet të shndërrohet në paralele të ndarë të shkollës fillore “Andon Zako Çajupi”, prandaj në të ardhmen nuk do të ketë drejtor, dhe për këtë arsye nuk është shpallur konkursi për drejtor, kurse për shkollën në Stroc, tha se që dy herë ka dalë konkursi, por nuk ka pasur të interesuar për të konkurruar për drejtor. Mandej lidhur me numrin e përgjithshëm të nxënësve dhe të arsimtarëve, tha se herën tjetër do t’ua dorëzon një tabelë ku janë të përfshirë të gjithë. Në fund tha se gjendja në arsim është shumë më e mirë se sa në të kaluarën.

**Besim Jashari-** tha se ka drejtor që e ka kualifikimin përkatës, por nga sa ka qenë drejtor, nuk ka dëshmuar se ka zotësi menaxhuese, prandaj kërkoi që të bëhet matja e performancës, dhe pyeti se kur do të ketë matje të performancës menaxhuese të drejtorëve nëpër shkolla?

**Qerim Selimi-** u përgjigj se ka drejtor të tillë, mirëpo ata e kanë një kontratë, dhe ndaj tyre do të merren masa, por masat më shumë do të jenë vërejtje, mirëpo në të ardhmen ose do të përmirësohen, ose do të largohen.



**Qazim Azemi-** pyeti si qëndron puna me nxemjen në shkollën “Bahri Kuçi”? Pastaj lidhur me shkollat në të cilat janë grumbulluar nga 47 nxënës, pyeti se çfarë suksesi mund të ketë?

**Qerim Selimi-** sa i përket nxemjes qendrore në shkollën “Bahri Kuçi”, tha se do të gjenden mjetet dhe do të realizojmë projektin në fjalë.

## **9. Shqyrtimi i Draft-Rregulloreve për organizimin e punës dhe të mësimin në shkollat fillore të Komunës së Vushtrrisë. (shqyrtim i dytë).**

**Vlora Qirezi-** tha se draftrregullorja që sot po shqyrtohet është shumë më cilësore, se sa kur është bërë shqyrtimi i parë i draftrregulloreve në fjalë. Pastaj paraqiti këto propozime lidhur me draftrregulloren në fjalë: te neni 5, ku përshkruhen të drejtat e nxënësve, propozoi që të shtohet edhe një pikë me këtë tekst “nxënësi ka të drejtë të shfrytëzojë bibliotekën e shkollës”. Kurse te neni 6, te obligimet e nxënësit, propozoi të shtohet një pikë me këtë tekst “nxënësi ka obligim të njoh dhe të respektojë kodin e mirësjelljes dhe rregullat e shkollës”. Te neni 9, kërkoi që të hiqet fjala “obligimet”, pasi që është tek neni 10, dhe propozoi që të shtohet pika 9.5, me këtë përmbajtje “prindi ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitetet e shkollës”. Në vazhdim tha se disa mësimdhënës i kushtëzojnë nxënësit që të mbajnë orë plotësuese private, dhe këtë me pagesë, prandaj në mënyrë që kjo dukuri të eliminohet, propozoi që në nenin 12 të inkorporohet edhe një pikë, me këtë përmbajtje “të mos kushtëzohen nxënësit për mbajtjen e orëve private, plotësuese me pagesë”. Gjithashtu grupi asambleistë i LDK-së i rekomandon Drejtorisë së Arsimit ta përcjellë zbatimin e këtyre rregulloreve nga ana e drejtorëve të shkollave dhe njëkohësisht të ndërmarrë masa ndaj atyre që nuk i zbatojnë rregulloret.

**Sabit Kadriu-** tha se të dy rregulloret janë plotësuar. Pastaj paraqiti vërejtje te neni 16.1, duke propozuar që të precizohen edhe detyrat dhe obligimet e këshillit të shkollës, dhe detyrat dhe obligimet e këshillit të nxënësve.

**Sami Istrefi-** tha se grupi asambleistë i PDK-së vlerëson lartë hartuesin e dy rregulloreve, që janë në shqyrtim të dytë në Kuvend. Pastaj tha se pasi që hartuesi nuk i ka paraparë dispozitat kalimtare, propozoi që të shtohet neni 23 me këtë përmbajtje “për zbatimin e kësaj rregulloreje të kujdeset Drejtoria e Arsimit”. Kurse në nenin 24 propozoi që të shtohet (nëse ka ndonjë rregullore tjetër), që me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, të shfuqizohet rregullorja që ka qenë deri sot në fuqi. Ndërsa në nenin 25 duhet të ceket se prej cilës datë hyn në fuqi kjo rregullore. Pra këto propozime të përfshihen në dy rregulloret.

**Qazim Azemi-** tha se në parim grupi asambleistë i AAK-së i përkrah draftrregulloret. Pastaj propozoi që te neni 8.5 të hiqet pjesa e fjalisë “kur nxënësi i klasës së I-rë bartë armë dhe sende tjera të rrezikshme në shkollë”, pasi që nxënësi i klasës së parë nuk vjen me armë. Kurse te organet qeverisëse, propozoi që të përfshihen edhe detyrat dhe obligimet e këshillit të shkollës. Ndërsa lidhur me kujdestarët e ditës, tha se është mirë që të paguhet kujdestaria, pasi që është jashtë norme, prandaj propozoi që edhe kujdestari i ditës edhe kujdestari ndihmës të paguhet me një shumë modeste, gjithashtu të paguhet edhe kujdestari i klasës. Në vazhdim nenit 21.1 propozoi që t’i shtohet edhe organizimi i ditës së shkollës. Në fund duke iu referuar kreut VII, tha se në arsim është hequr emërtimi “shërbyesit civilë”.

**Ferit Idrizi-** lidhur me nenin 11 .7 propozoi që të korrigojë dhe të thuhet “...plotëson librezat dhe dëftesat e nxënësve...”. Kurse te neni 11.9 propozoi që t’i shtohet “...apo zv.drejtorit”.

**Besim Jashari-** tha se pasi që ka një rol të rëndësishëm këshilli i shkollës, pyeti se a paguhet ai këshill, duke shtuar se ndryshe është kur këshilli paguhet, pasi që edhe përgjegjësia e këshillit është më e madhe për besimin që e ka marrë.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

***Aprovohet Rregullorja në fjalë duke përfshirë vërejtjet dhe sugjerimet e diskutuesve.***

**10. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për organizimin e punës dhe të mësimin në shkollat e mesme të ulëta të Komunës së Vushtrrisë. (shqyrtimi i dytë).**

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

***Aprovohet Rregullorja në fjalë duke përfshirë vërejtjet dhe sugjerimet e diskutuesve.***

**11. Shqyrtimi i propozimvendimit për ndarjen e çmimit “Hasan Prishtina” për familjen e Komandantit legjendar Adem Jashari.**

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:**

***Familja Jashari e Komandantit legjendar Adem Jashari nga fsh. Prekaz, Komuna e Skenderajt nderohet me çmimin “Hasan Prishtina”.***

**12. Eventuale:**

**Pyetjet e anëtarëve të Kuvendit**

**Qazim Azemi-** pyeti pse nuk ka ndriçim publik në qytet?

**Bajram Mulaku-** u përgjigj se persona të pandërgjegjshëm po i vjedhin trupat ndriçues, dhe në këtë mënyrë po dështon i tërë sistemi elektrik.

**Qazim Azemi-** pyeti lidhur me pensionistët e Komunës së Vushtrrisë, të cilët janë në arsim dhe nuk iu njihet stazhi i punës në periudhën 1990-1999, dhe shtoi se ka punëtor që ka punuar 40 vite, dhe nuk e gëzon pensionin e plotë.

**Qerim Selimi-** u përgjigj duke njoftuar se për çështjen në fjalë është angazhuar edhe Ministria e Arsimit, dhe ia kanë sjellur disa formular Drejtorisë së Arsimit në Vushtrri dhe janë duke u përgatitur formularët, duke i marrë të gjitha shënimet për të gjithë punëtorët, pra çështja është në proces e sipër.

**Refik Ramaj-** pyeti se a ka mundësi Komuna me bërë diçka më shumë në mënyrë që qyteti me qenë pak më i pastër?

**Bajram Mulaku-** u përgjigj se janë duke bërë përpjekje të mëdha për të bërë diçka në funksion të pastërtisë së qytetit, duke paraqitur si pengesë dy elemente: njëri, fakti që kompania është regjionale dhe nuk po e menaxhon Komuna, por njoftoi se janë duke u munduar tre kryetarët e komunave të regjionit me bërë ndarjen, dhe me bërë pronë të Komunës, kurse fakti tjetër është që mjetet që janë në dispozicion për ta menaxhuar higjienën, po duhet me shpallë tender. Në fund tha se megjithatë janë bërë disa ndryshime pozitive në favor për një higjienë më të mirë, dhe njëkohësisht njoftoi se prej 1 nëntorit do të hiqen kontinjertë e mbeturinave nga rrugët kryesore të qytetit, dhe me një rregullore me i obliguar të gjitha dyqanet dhe njerëzit që kanë shtëpi rreth këtyre rrugëve, me i pasë kontejnerët e vet, pastaj kompania me bërë marrjen (mbledhjen) e mbeturinave.

**Syzana Sylja-** paraqiti dy kërkesa: kërkoj nga Drejtoria e Inspeksionit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike që menjëherë të merren masa emergjente që të vendoset një kontejner për mbeturina pranë hyrjes së shkollës fillore “Naim Frashëri”, sepse qytetarët që banojnë afër shkollës në fjalë po i hedhin mbeturinat pranë hyrjes së shkollës, poashtu gjatë të reshurave atmosferike, para shkollës po mblidhen të reshurat atmosferike, kurse kanali për ujëra atmosferike është i mbyllur dhe nuk e tërheq ujën, prandaj nxënësit nuk mund të kalojnë pa u ndotur, kur bjen shi. Kurse kërkesën e dytë e paraqiti në emër të banorëve të fshatit Mihaliq, të cilët kanë

problem me ujërat e zeza, pasi që edhe kanë qenë në projekt për vendosjen e kanalizimit, dhe është premtuar nga institucionet e pushtetit lokal, por nuk është bërë zgjedhja, ndërsa banorët kanë hall të madh, pasi që edhe ujërat e puseve nuk mund të përdoren.

**Bajram Mulaku-** iu përgjigj se premtimet që i ka dhënë, janë premtime që do të realizohen brenda mandatit të tij 4 vjeçar.

**Veli Karaça-** pyeti se çka po ndërmerret për parandalimin e uzurpimit të pronave publike, dhe shtoi se vetëm në rrugën për në Gojbulë janë disa raste që është uzurpuar prona publike. Poashtu pyeti lidhur me vendosjen e pengesave nëpër rrugët e asfaltuara, pasi që është bërë një dukuri e papranueshme që njerëzit pa lejen e askujt vendosin pengesa të përmasave të mëdha, duke i bërë rrugët e pakalueshme, dhe përmendi konkretisht rrugën “Lutfi Musiqi”, e cila ka dy pengesa të tilla.

**Bajram Mulaku-** tha se fenomeni i uzurpimeve nuk ka të bëjë me mandatin e tij, por është fenomen i mentalitetit tonë.

**Besim Jashari-** kërkoi Informatë lidhur me gjendjen, dëmtimin dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë. Pastaj lidhur me rrugët që po asfaltohen, paraqiti vërejtje pasi që në pjesën anësore nuk e kanë të rregulluar trotuarin, dhe si të tilla rrugët dëmtohen, prandaj kërkoi që të merren masa që rrugët që po asfaltohen të mbrohen. Gjithashtu kërkoi masa rigoroze nga Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë së Inspeksionit për mbrojtjen e konsumatorëve, duke përmendur si shembull papastërtinë e madhe nëpër kafeçajtore. Mandej kërkoi nga Drejtoria e Inspeksionit që të merren masa për ndalimin e ekspozimit të mallit para dyqaneve. Në fund e mbështeti largimin e kontejnerëve të mbeturinave nga rrugët kryesore të qytetit.

**Sami Istrefi-** pyeti lidhur me vendimin që është marrë në Kuvendin e Komunës për kompensimin e shujtës për shërbyesit civilë të administratës së Komunës?

**Bajram Mulaku-** u përgjigj se është duke u angazhuar në vazhdimësi për ta realizuar sa më parë vendimin në fjalë.

**Mbledhja përfundoi në orën 15:35.**

**Procesmbajtësi:**  
**Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Ferit Idrizi**